UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 219, datë 8.11.2022

PËR PROCEDURAT PËR ORGANIZIMIN E OPERACIONEVE TË KTHIMIT DHE OPERACIONEVE TË PËRBASHKËTA TË KTHIMIT NË RRUGË AJRORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 124, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me qëllim harmonizimin e procedurave të organizimit dhe pjesëmarrjes në fluturimet e përbashkëta për largimin/dëbimin nga territori i dy ose më shumë shteteve të shtetasve të vendeve të treta që janë subjekt i urdhrave individualë të largimit/dëbimit nga Republika e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përshkruhen procedurat standarde të përbashkëta, të cilat thjeshtëzojnë organizimin dhe pjesëmarrjen në fluturimet e përbashkëta të kthimeve. Ky udhëzim është përgatitur si një instrument praktik për të dhënë direktiva për autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe pjesëmarrjen në operacionet e përbashkëta të kthimit bazuar në eksperiencën e vendeve të BE-së në fushën e largimit/dëbimit të shtetasve të vendeve të treta, të cilët qëndrojnë ilegalisht dhe që janë subjekte të urdhrave individuale të largim/dëbimit.

1. Termat dhe përkufizimet

2. Largimi/dëbimi nëpërmjet fluturimeve të përbashkëta nga territori i dy ose më shumë shteteve të shtetasve të vendeve të treta që janë subjekt i urdhrave individuale të largim/dëbimit.

2.1 Faza e parakthimit

2.1.1 Destinacioni i Operacionit të Përbashkët të Kthimit
2.1.2 Data dhe koha e Operacionit të Përbashkët të Kthimit
2.1.3 Zgjedhja e aeroportit
2.1.4 Numri total i vendeve
2.1.5 Numri i vendeve në dispozicion
2.1.6 Zgjedhja e një avioni
2.1.7 Orari i fluturimit
2.1.8 Kosto e avionit
2.1.9 Pesha e bagazheve
2.1.10 Para xhepi
2.1.11 Masat shtrënguese
2.1.12 Gjuha e përdorur
2.1.13 Koha e mbërritjes së shteteve pjesëmarrëse në aeroportin e nisjes.
2.1.14 Oferta e operacionit të kthimit
2.1.15 Informimi i ambasadave
2.1.16 Pala (ekipi) e avancuar
2.1.17 Pika e kontaktit për krizat gjatë 24-orëve, gjatë gjithë ditëve të javës
2.1.18 Prezenca e OJF-ve/ambasadave/ministrive gjatë operacionit
2.1.19 Kodi i veshjes
2.1.20 Akomodimi
2.1.21 Pagesa e akomodimit

2.1.22 Etiketat për bagazhet
2.1.23 Njohja e eskortave dhe e zyrtarëve
2.1.24 Vaksinimet
2.1.25 Stafi mjekësor dhe përkthyesit
2.1.26 Eskortat
2.1.27 Skuadra mbështetëse
2.1.28 Dokumentacioni
2.1.29 Transportimi për në avion
2.1.30 Zonat e veçanta të aeroportit
2.1.31 Lista e pasagjerëve
2.1.32 Vlerësimi i riskut
2.1.33 Plani i uljes
2.1.34 Takimi me shoqërinë ajrore
2.1.35 Kushtet mjekësore dhe informimi
2.1.36 Qëndrimi gjatë natës
2.1.37 Lista e kontakteve
2.1.38 Kontrolli i avionit
2.1.39 Plani B
2.1.40 Takimi me shefat e eskortave

2.2. Faza e paranisjes

2.1.41 Kontrolli i zonave të veçanta
2.1.42 Një informim i shkurtër i eskortave
2.1.43 Prezenca e një doktori
2.1.44 Kontrolli i dokumenteve
2.1.45 Kontrolli trupor i të kthyerve
2.1.46 Kontrolli i bagazheve
2.1.47 Vendosja e etiketave tek bagazhet
2.1.48 Sendet personale
2.1.49 Lista finale e pasagjerëve
2.1.50 Kontrolli i avionit
2.1.51 Përgatitja e avionit
2.1.52 Transportimi i shteteve pjesëmarrëse
2.1.53 Ngarkimi i bagazheve
2.1.54 Informim i shkurtër i shefave të eskortave, vëzhguesve, stafit mjekësor, përkthyesve
2.1.55 Informim i shkurtër i ekuipazhit
2.1.56 Procesi i hipjes në bord (imbarkimi)

3.3 Faza e fluturimit

3.3.1 Përmbushja e marrëveshjeve
3.3.2 Shefi i operacionit/shefi i eskortave
3.3.3 Përdorimi i masave shtrënguese
3.3.4 Sendet personale të të kthyerve

3.4 Faza e mbërritjes

3.4.1 Kontakti i parë me autoritetet lokale
3.4.2 Dorëzimi i të kthyerve
3.4.3 Qëndrimi nëse rrihet për një natë/nëse qëndrohet për një natë

3.5 Faza e fluturimit të kthimit pas përfundimit të operacionit

3.5.1 Konsumimi i pijeve alkoolike
3.5.2 Analiza

3.6 Raporti final i operacionit të kthimit

4. Trajnim i standardizuar për oficerët e kthimit të përbashkët

5. Lista e shkurtimeve

SHO Shteti organizator
OK Operacion kthimi
SHP Shteti pjesëmarrës
OPK Operacion i përbashkët kthimi
DE Drejtues i eskortës
ON Oficer ndërlidhës

1. TERMA DHE PËRKUFIZIME

Fluturim i përbashkët kthimi: është transporti i shtetasve të vendeve të treta i kryer nga një transportues ajror i zgjedhur për këtë qëllim.

Shtet organizator *Shteti i cili është përgjegjës për organizimin e fluturimeve të përbashkëta.*

Shtet pjesëmarrës *Shteti i cili merr pjesë në fluturime të përbashkëta të organizuara nga një Shtet Organizator.*

Para xhepi *Një shumë parash e dhënë personit që do të kthehet para se të mbërrijë në vendin e destinacionit. Synohet të mbulohen shpenzimet imediate që mund të ketë i kthyeri me mbërritjen e tij. P.sh. kosto e transportit nga aeroporti për në qytetin e tij.*

Pala (ekipi) e avancuar *Një delegacion i përfaqësuesve të vendeve që e drejtojnë/marrin pjesë, të cilët udhëtojnë për në vendin/vendet e destinacionit përpara se fluturimi i përbashkët të mbërrijë në këto vende.*

Skuadra mbështetëse *Grup eskortash që jepen nga Shteti Organizator, i cili shërben si mbështetje për eskortat, veçanërisht për fluturimet e distancave të gjata.*

I përshtatshëm për fluturim *Kushtet fizike të të kthyerve, të cilat pajtohen (janë të përshtatshme) për një kthim të sigurt nga ajri. Shiko Aneksi i CD 2004/573. Pika 1.1.2*

Plani B *Plani i Kontigjencës që duhet përgatitur në rastet kur fluturimet e Përbashkëta të Kthimit dështojnë, apo ndeshen me refuzimin e të kthyerit/kthyerve për t'u kthyer në vendin e destinacionit. Neni 2 i Aneksit CD 2004/573.*

2. PROCEDURAT E ORGANIZIMIT PËR LARGIMIN NGA AJRI TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA QË JANË SUBJEKTE TË URDHRAVE INDIVIDUALE TË LARGIM/DËBIMIT.

2.1 Faza e parakthimit

2.1.1 Destinacioni i Operacionit të Përbashkët të Kthimit

Autoriteti shtetëror qëndror përgjegjës për trajtimin e të huajve zgjedh dhe specifikon vendin/vendet e destinacionit të OPK sipas:

Nevojave: pranisë së migrantëve të parregullt të një shtetësie të dhënë.

Pranimit të fluturimit dhe të kushteve të aplikuara nga vendi/vendet e treta.

Preferohet të ketë vetëm një vend destinacioni. Nuk mund të kthesh në më shumë se dy vende njëkohësisht. Vendet duhet të jenë sa më afër që të jetë e mundur dhe me to duhet kontaktuar më parë, në një kohë të duhur, mbi organizimin e OPK.

2.1.2 Data dhe koha e Operacionit të Përbashkët të Kthimit

Kur zgjidhet data dhe koha shteti organizator (në vijim "SHO"), duhet:

- të marrë parasysh ditët e pushimeve zyrtare dhe/ose kombëtare si dhe kushtet kulturore, fetare të vendit të tretë;

- të merret parasysh pranimi i vendit të tretë për një kohë dhe datë të dhënë;

- të marrë parasysh kohën se sa do të zgjasë sjellja e të kthyerve të tyre nga ana e SHP shteteve pjesëmarrëse (në vijim "SHP"), në pikën e nisjes.

2.1.3 Zgjedhja e aeroportit

SHO duhet të zgjedhë një aeroport ndërkombëtar për organizimin e operacionit të përbashkët të kthimit, duke marrë parasysh gjithashtu edhe orët e punës së aeroportit. Aeroporti duhet të ketë staf policor të mjaftueshëm në dispozicion, si dhe në këtë aeroport duhet të jetë mundësia që të vihet në dispozicion një hapësirë për operacionin pa aksesin e publikut, në rast se kjo do të nevojitej.

2.1.4 Numri total i vendeve

Numri total i vendeve do të varet nga numri i nevojave (numri i të kthyerve nga vendi/vendet e treta të zgjedhura apo nga numri dhe përbërja e eskortave), si dhe nga kufizimet e mundshme nga vendi/vendet e treta. Rekomandohet që me një fluturim të mos kthehen më shumë se 40 veta. Në përbërje të eskortës do të marrin pjesë staf mjekësor, përkthyes, monitorues i të drejtave të njeriut (përfaqësues i Avokatit të Popullit) apo përfaqësues të OJF-ve.

2.1.5 Numri i vendeve në dispozicion

SHO duhet të vendosë numrin e vendeve që ka nevojë. Pastaj ai duhet të këshillojë SHP mbi numrin e vendeve në dispozicion për përdorim për eskortat e tyre dhe për të kthyerit.

2.1.6 Zgjedhja e një avioni

Në mënyrë që të zgjidhet një avion për të siguruar operacionin e përbashkët të kthimit, SHO duhet t'i drejtohet një agjencie ose një kompanie ajrore duke respektuar procedurat normative ligjore të parashikuara.

Vendi i destinacionit, numri i vendeve që nevojiten, masat e sigurisë, kostot, kushtet dhe kërkesat për sigurinë etj., janë faktorë të cilët duhet të merren në konsideratë gjatë përzgjedhjes së kompanisë ajrore.

Në rastet kur është e mundur, duhet të përzgjidhet një linjë ajrore, e preferueshme që ekuipazhi i saj të jetë me eksperiencë në kryerjen e fluturimeve të kthimeve.

SHO sigurohet që të përfshijë në kontratë një garanci për përgjigjen në kohë, nëse avionit i ndodh ndonjë defekt teknik. Në këtë rast bëhet zëvendësimi i avionit në një hark kohor të përshtatshëm. Kontrata do të nënshkruhet bazuar në parashikimet ligjore në fuqi.

2.1.7 Orari i fluturimit

Orari i fluturimit duhet të përgatitet nga shoqëria ajrore, duke ndjekur udhëzimet e SHO dhe bazohet në faktorë të tillë si vendi dhe ora e nisjes, numri i pikave ku do të merren personat, si dhe nevoja për ndalesa teknike (si p.sh. për mbushje me karburant dhe/ose për ndërrimin e ekuipazhit).

2.1.8 Kosto e avionit

Autoriteti kompetent ligjor cakton çmimin për një vend, bazuar në çmimet e fluturimit të vendosura nga shoqëria ajrore, sipas tipit të avionit dhe rrugës që do të kryhet.

2.1.9 Pesha e bagazheve

Pesha e bagazheve të lejuara për të kthyerit nuk duhet që t'i kalojë 30 kg. SHP duhet që të informojë SHO nëse ka ndonjë situatë të veçantë në lidhje me bagazhet.

2.1.10 Paratë e xhepit

Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që organizon fluturimin dhe shteti pjesëmarrës, marrin parasysh dhënien e parave të xhepit në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara. Në mënyrë që të evitohet ndonjë ngërç i mundshëm, shuma e parashikuar jepet para se të fillojë operacioni (i kthimit), si dhe shtetet që marrin pjesë në operacion bien dakord me marrëveshje, përpara fillimit të saj.

2.1.11 Masat shtrënguese

Megjithëse niveli i masave shtrënguese që do të përdoren do të vendoset nga SHO (i cili duhet që t'ia komunikojë të gjitha këto vendime Shtetit Pjesëmarrës), në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar, asnjë Shtet Pjesëmarrës nuk do të përdorë ato masa shtrënguese që nuk lejohen nga legjislacioni i tij, edhe pse këto masa janë pranuar nga SHO për këtë operacion.

2.1.12 Gjuha e përdorur

Shtetet pjesëmarrëse (SHO+SHP) bien dakord mbi gjuhën që do të përdoret gjatë operacionit.

2.1.13 Koha e mbërritjes së shteteve pjesëmarrëse në aeroportin e nisjes

Shteti/et Pjesëmarrëse sjellin të kthyerit e tyre te vendi i nisjes, jo më vonë se 3 (tri) orë para nisjes së avionit.

Shteti pjesëmarrës lajmëron shtetin organizator mbi kohën dhe metodat e mbërritjes në aeroportin e nisjes.

2.1.14 Oferta e operacionit të kthimit

Kur të gjitha hapat përgatitore të kenë përfunduar, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që organizon fluturimin, dërgon një ofertë me të gjithë informacionin, ku përcaktohet edhe një afat skadimi për dhënien e përgjigjes për pikën e kontaktit të SHO-së dhe për Agjencinë FRONTEX, në rastet kur kjo e fundit është përfshirë.

Përgjigja duhet kthyer brenda këtij afati skadence, si për SHO-në, ashtu edhe për FRONTEX-in.

2.1.15 Informimi i ambasadave

Pasi merren të gjitha përgjigjet nga shtetet pjesëmarrëse (SHP), SHO njofton të dyja ambasadat, si ambasadën e tij në shtetin/shtetet e destinacionit, ashtu edhe ambasadën/ambasadat e shtetit/shteteve të destinacionit në territorin e shtetit të tij, mbi çështjet e mëposhtme:

- numrin dhe emrat e shteteve pjesëmarrëse;
- orarin e fluturimit;
- numrin e të kthyerve; si dhe
- numrin e eskortave të tyre.

SHO gjatë kësaj faze mund të kërkojë ç'do mbështetje diplomatike të nevojshme në aeroportin e mbërritjes, si dhe informacion/mbështetje në rastet kur është i nevojshëm qëndrimi për një natë në vendin e destinacionit.

2.1.16 Pala (ekipi) e avancuar

SHO mund të dërgojë një ekip të avancuar, i cili në bashkëpunim/koordinim me autoritetet e destinacionit dhe me përfaqësinë diplomatike të shtetit të tij do të ndihmojë në finalizimin e detajeve dhe do të rrisë mundësinë që operacioni të ketë sukses.

Çdo palë pjesëmarrëse duhet të dërgojë jo më shumë se 2 (dy) përfaqësues. Çdo ekip i avancuar duhet që të mbërrijë pak ditë përpara mbërritjes së avionit të kthimeve, në mënyrë që të takojë autoritetet kompetente të vendit të destinacionit, për të dhënë informacione rreth të kthyerve dhe të bihet dakord mbi detajet e dorëzimit/përpunimit nga ana e autoriteteve kompetente me mbërritjen e avionit.

Anëtarët e ekipit të avancuar *de facto* do të bëhen personat e kontaktit për autoritetet e huaja në raste problemesh me të kthyerit. Të gjitha vendet pjesëmarrëse duhet t'i japin informacion ekipit të avancuar mbi të kthyerit e tyre p.sh. të dhëna personale dhe informacion mbi dokumentet e tyre të udhëtimit.

2.1.17 Pika e kontaktit për krizat gjatë 24 orëve, gjatë gjithë ditëve të javës

Si SHO, ashtu edhe shteti/shtetet pjesëmarrës, caktojnë një person përgjegjës për operacionin dhe/ose një pikë kontakti për krizat i cili do të mund të kontaktohej në çdo kohë. Shteti pjesëmarrës duhet të informojë mbi caktimin e personit përgjegjës SHO.

2.1.18 Prania e OJF-ve/ambasadave/ministrive gjatë operacionit

SHO njofton shtetin pjesëmarrës kur përfaqësues të OJQ-ve/ambasadave/ministrive kanë qëllim që të jenë të pranishëm gjatë operacionit të kthimit.

Kur përfaqësues të OJQ-ve/ambasadave/ministrive të SHP kanë qëllim që të jenë të pranishëm gjatë operacionit të kthimit, shteti pjesëmarrës (SHP) paraprakisht dakordësohet me shtetin organizator (SHO).

2.1.19 Kodi i veshjes

Kodi i veshjes për eskortat, zyrtarët gjatë operacionit do të varet nga zgjatja e tij dhe nga kushtet. Normalisht uniformat apo stili ushtarak i veshjeve nuk duhet të përdoret.

2.1.20 Akomodimi

Nëse kërkohet që të qëndrohet një natë, ose në një vend transiti, ose në vendin e destinacionit, atëherë SHO merr masa dhe rregullon një akomodim të përshtatshëm.

SHO i ofron SHP asistencë për të gjetur akomodim që kur janë në pikën e nisjes përpara dhe/ose pas operacionit. SHP duhet që ta informojë SHO mbi numrin dhe llojin e dhomave që do t'i duhen në këto kushte.

2.1.21 Pagesa për akomodimin

Kur nevojitet qëndrim për një natë SHO duhet të informojë SHP mbi formën e pagesës për çdo akomodim që është gjetur.

2.1.22 Etiketat për bagazhet

Kur përfshihet më shumë se një destinacion bagazhet për destinacione të ndryshme duhet të shënohet me ngjyra të ndryshme. Nëse duhet që bagazhet e eskortave të mbahen në mbajtëset e avionit këto bagazhe duhet gjithashtu të shënohen me një tjetër ngjyrë. Në këto raste rekomandohet ngjyra blu.

2.1.23 Njohja e eskortave dhe e zyrtarëve

Eskortat dhe zyrtarët në bord duhet të jenë plotësisht të dallueshëm nga të kthyerit. Për këtë qëllim ata veshin disa shenja, ose rroba dalluese, të tilla si: shirita krahu, jelekë ose të mbajnë distinktiv (*badge*).

2.1.24 Vaksinimi

Personeli i eskortave kryen të gjitha vaksinat kur fillojnë të punojnë në operacione të tilla dhe kjo mbrojtje do të zgjasë gjatë gjithë kohës së zgjatjes së punësimit në këto operacione.

Të gjitha shtetet duhet të kontrollojnë nëse kërkohet ndonjë lloj vaksinimi nga ndonjë vend i tretë, si kusht për hyrje, p.sh. nëse do të qëndrohet një natë, dhe nëse të gjithë zyrtarët e tyre janë të vaksinuar.

SHO dhe SHP janë përgjegjëse për shëndetin e eskortave të shteteve të tyre.

2.1.25 Stafi mjekësor dhe përkthyesi

SHO duhet që të organizojë praninë e stafit mjekësor gjatë gjithë operacionit (përfshirë fazat e paranisjes; në avion dhe gjatë fluturimit të kthimit). Gjithashtu ky shtet duhet të marrë në konsideratë nevojën për të pasur një përkthyes në bord në varësi të destinacionit.

SHP mund të sjellë përkthyesin/përkthyesit e tij si dhe staf mjekësor nëse ky shtet e konsideron këtë të nevojshme. SHP duhet që të marrë më parë pëlqimin e SHO mbi praninë në bord të mjekut të vet.

2.1.26 Eskortat

Si eskortat e SHO, ashtu edhe eskortat e SHP, duhet që të jenë të trajnuara në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Numri i eskortave duhet që të përcaktohet në dritën e një vlerësimi risku të duhur.

Çdo vend duhet që të emërojë një shef eskorte, ose një person përgjegjës për të gjithë skuadrën. Rekomandohet që shefat e eskortës të kenë ndjekur trajnimin e FRONTEX: "Trajnimi standard për oficerët e kthimeve të përbashkëta".

2.1.27 Skuadra mbështetëse

Duhet gjithashtu të ketë një skuadër mbështetëse eskortash (varet nga kushtet që do të përfshihen) për të mbështetur të gjitha eskortat (të SHO dhe të SHP) gjatë gjithë operacionit (përfshi fazat e paranisjes; në avion dhe gjatë fluturimit të kthimit).

SHP mund të sjellë një skuadër mbështetëse për të dhënë asistencë eskortave të shtetit të vet.

2.1.28 Dokumentacioni

Çdo Shtet që merr pjesë në operacion është përgjegjës për të siguruar dhe zotëruar dokumentacionin e duhur për të kthyerit e tij (pasaportat kombëtare, dokumentin emergjent të udhëtimit/lejen kalimit apo të tjera të parashikuara).

2.1.29 Transportimi për në avion

SHO organizon mjetet e transportit për të gjithë të kthyerit dhe eskortat.

Transportimi rregullohet ose nga ndonjë vend pritje i veçantë/vend i veçantë për operacione të tilla, ose direkt nga qendrat e mbyllura.

2.1.30 Zonat e veçanta të aeroportit

Këto zona rekomandohen në varësi të nevojave të të dy shteteve, të SHO dhe të SHP.

Nëse të kthyerit nuk do të sillen direkt nga Qendrat e Mbyllura për në avion, një zonë e sigurt e veçantë për të ushtruar kontrollin dhe imbarkimin duhet të vihet në dispozicion.

Kjo zonë përmban disa nënzona, si p.sh.: nënzona e kontrollit, e ndihmës mjekësore, për tualetin, për pirjen e duhanit, për ushqimin, për mbledhjet etj.

2.1.31 Lista e pasagjerëve

SHO duhet të përgatisë dhe të dërgojë të paktën dy tipa të ndryshëm listash të të gjithë pasagjerëve, si të SHO ashtu edhe të SHP.

Një prej tyre i duhet dërguar shoqërisë ajrore duke përfshirë emrat, mbiemrat dhe datën e lindjes. Lista e dytë është për përdorim të brendshëm.

SHP duhet që të dërgojë informacionin e kërkuar mbi të kthyerit, eskortat dhe zyrtarët brenda afatskadencës të vendosur nga SHO.

2.1.32 Analiza e riskut

SHP duhet që të dërgojë informacionin e kërkuar mbi të kthyerit e dhunshëm të mundshëm, brenda afatskadencës të vendosur nga SHO.

2.1.33 Plani i uljes

Në hartimin e planit të uljes SHO kërkon fillimisht nga shoqëria ajrore një plan-vendosje të avionit. Më pas duhen pasur parasysh këto udhëzime:

- Asnjë i kthyer nuk duhet të ulet pranë daljeve të emergjencës/dhe ose pranë pajisjeve të avionit.
- Të kthyerit më të dhunshëm duhen vendosur në pjesën e pasme.
- Një (ose më shumë, kjo do të varet nga avioni) tualete duhen përshtatur vetëm për tu përdorur nga të kthyerit.
- Avioni duhet të ndahet në sektorë të ndryshëm kombëtarë, të ndarë, nëse do të ishe e mundur nga një radhë bosh.
- Zona specifike, zakonisht në krye të avionit duhen rezervuar për drejtuesit, për përfaqësuesit zyrtarë, për personelin mjekësor etj. Vendet për personelin mjekësor duhen shënuar në mënyrë të qartë në planin e uljes.
- Rekomandohet që dy vende të jenë të rezervuara për Drejtuesit e Eskortave, njëri vend në krye të avionit me drejtuesin e operacionit dhe tjetri në zonën e tij/saj kombëtare.
- Nëse do të ketë një skuadër mbështetëse, ajo duhet vendosur në mes dhe/ose në pjesën e fundit të avionit.
- I duhet treguar kujdes gjithashtu rezervimit të disa vendeve për ekuipazhin për të pushuar gjatë udhëtimeve të gjata, nëse do të jetë një udhëtim i tillë duhet marrë parasysh gjatë hartimit të planit të uljes.

Secili drejtues eskorte duhet të pajiset me një kopje të planit të uljes.

2.1.34 Takimi me shoqërinë ajrore

SHO duhet të mbajë një takim me shoqërinë ajrore në këtë fazë, sidomos nëse shoqëria ajrore nuk ka eksperiencë të mëparshme në këtë lloj operacioni. Kompania duhet informuar

mbi procedurat e hipjes në avion (imbarkimit) dhe procedurat e fluturimit të kthimit, si p.sh. në lidhje me kateringu-n (ushqimi, pijet, duke përfshirë këtu edhe politikat e mos përdorimit të pijeve alkolike), me orarin, rregullat, në lidhje me kontaktet me të kthyerit, lëvizjet në bord, planin e uljes, aktivitetet e zbavitjes në bord (si p.sh. shfaqja e filmave, muzika) etj.

SHO duhet ti kërkojë shoqërisë ajrore që të vërë në dispozicion një ekuipazh me eksperiencë dhe bashkëpunues.

2.1.35 Kushtet mjekësore dhe informimi

SHO dhe SHP duhet të kontrollojnë të gjithë të kthyerit nëse ata janë në gjendjen e duhur shëndetësore që i lejon ata/ato të fluturojnë (në formë shëndetësore për fluturim).

Personeli mjekësor në bord duhet informuar që më parë për çdo kondicion mjekësor që ndikon te ndonjë i kthyer.

SHP duhet të dërgojë informacionin e kërkuar brenda afatave kohore të përcaktuara.

SHO ka të drejtën të refuzojë aksesin për në fluturimin e përbashkët të kujtdo të kthyeri të SHP-së, nëse ai/ajo konsiderohet të mos jetë " *në formë shëndetësore për fluturim".*

2.1.36 Qëndrimi gjatë natës

Rekomandohet që i gjithë operacioni të kryhet gjatë natës në mënyrë që të evitohen qëndrimet. Kur kjo është e paevitueshme preferohet për të gjithë personelin që të flenë në një hotel të vetëm.

Kur duhen përdorur disa hotele, duhen përgatitur lista që më parë për se kush do të rri në hotelet respektive.

Grupet kombëtare nuk duhet të ndahen, vetëm në rastet se nuk do të ketë ndonjë alternativë tjetër.

Për secilin grup duhet caktuar një person përgjegjës.

Shteti pjesëmarrës duhet të informohet, më parë se të kryhet operacioni, në lidhje me hotelin (p.sh. detajet e kontaktit, vendi, mënyra e pagesës, si dhe në lidhje me rregullimin e transportit nga aeroporti në hotel, si dhe nga hoteli në aeroport).

2.1.37 Lista e kontaktit

SHO duhet që të japë një listë kontakti i cili të përfshijë numrat e telefonit dhe adresat si në vendet e destinacionit ashtu edhe në vendet e transitit të: pikave të kontaktit për krizat, ambasadat, të oficerit ndërlidhës të migracionit, të shefit të operacionit, të hotelit, të shoqërisë ajrore, të FRONTEX, dhe të anëtarëve të ndonjë skuadre të avancuar.

SHO duhet që të pajisë pikën e kontaktit për krizat të SHP dhe shefin e operacionit me këtë listë.

SHP duhet që t'i japë SHO kontaktet e pikës së tij të kontaktit për krizat dhe të shefit të eskortës së këtij shteti.

2.1.38 Kontrolli i avionit

SHO duhet që të identifikojë përgjegjësitë e stafit për të kryer kontrollet e sigurisë së avionit, përpara se të nisë operacioni.

2.1.39 Plani B (në rastet e dështimit të kthimit të një personi, p.sh. qëndrimi gjatë natës)

Kur një të kthyeri i refuzohet hyrja për në vendin e destinacionit dhe është planifikuar qëndrimi për një natë, atëherë SHO duhet që të planifikojë një rrugë alternative, duke marrë parasysh kohën e shërbimit të ekuipazhit, si dhe destinacionet më të përshtatshme të cilat do të varen nga kërkesat për vizë, niveli i sigurisë, çështjet teknike etj.

Duhet parë gjithashtu mundësia e fluturimeve direkte për të kthyerit dhe eskortën e tij/saj duke përdorur një fluturim linje.

Në kushte të tilla secili shtet duhet që të marrë përgjegjësitë për transportin e të kthyerve të tij në territorin e tij.

Secili shtet pjesëmarrës duhet gjithashtu të përgatisë paraprakisht një plan B.

2.1.40 Takimi me shefat e eskortave

Rekomandohet që të mbahet një mbledhje ku të takohen shefi i operacionit, shefat e eskortave dhe personeli mjekësor, menjëherë përpara operacionit.

Në mbledhje diskutohen të gjitha çështjet e përmendura më sipër.

Kjo mbledhje mbahet në aeroportin e nisjes për të mundësuar personelin përgjegjës që të kontrollojë ambientet.

3.2 Faza e para nisjes

3.2.1 Kontrolli i zonave të veçanta

Aty ku është rënë dakord për zona të veçanta (qoftë zona operative apo zona për pritje), këto zona duhet të jenë subjekte të kontrollit të sigurisë dhe teknik para nisjes së avionit.

3.2.2 Një informim i shkurtër i eskortave

Menjëherë para se të nisë operacioni, shefi i eskortave të shtetit organizator duhet që të informojë eskortat e tij/saj. Po kështu edhe shefi i eskortave të SHP duhet që të informojë eskortat e tij/saj përpara se të nisen për në pikën e nisjes.

3.2.3 Prania e mjekut

Një doktor/ekip doktorësh duhet që të jetë/jenë të pranishëm gjatë operacionit që nga mbërritja e të kthyerve në aeroportin e nisjes deri në zbritjen e tyre në vendet e destinacionit.

3.2.4 Kontrolli i dokumenteve

Megjithëse përgatitja e dokumenteve është pjesë e fazës së parakthimit, përsëri një person/ekip duhet caktuar për të kontrolluar dokumentet e udhëtimit, si të të kthyerve ashtu edhe të eskortave, menjëherë para hipjes në bord.

SHP duhet që të kryejë kontrolle të njëjta përpara hipjes në avion në vendin e tyre.

3.2.5 Kontrolli trupor i të kthyerve

Kontrollet trupore të të kthyerve duhen kryer ose në qendrën e mbyllur ose në zonën e operacionit. Nëse është e mundur ky kontroll duhet kryer nga një skuadër e ndryshme nga ajo e eskortave.

3.2.6 Kontrolli i bagazheve

Kontrolli i bagazheve të të kthyerve kryet, ose në qendrën e mbyllur, ose në zonën e operacionit. Ndiqen rregullat e duhura të sigurisë që ndjekin linjat ajrore.

3.2.7 Vendosja e etiketave te bagazhet

Bagazheve të eskortave dhe të të kthyerve u vihen etiketat.

3.2.8 Sendet personale

Sendet personale të të kthyerve nuk mund të trajtohen si bagazhe që mbahen nga vetë të kthyerit, por mbahen nga eskortat/shefat e eskortave. Rekomandohet që këto sende të futen në qese transparente.

3.2.9 Lista finale e pasagjerëve

Duhet përfunduar një listë finale e pasagjerëve menjëherë para se të hipet në avion, si dhe i duhet dorëzuar linjës ajrore.

3.2.10 Kontrolli i avionit

Duhen kryer kontrolle sigurie të kabinës, për eksplozivë, artikuj të rrezikshëm etj. Pasi këto kontrolle të jenë përfunduar avioni duhet të rri nën ruajtje.

Të kryet kontrolli nëse plani i uljes nëpër vende korrespondon me konfiguracionin e avionit.

3.2.11 Përgatitjet e avionit

Nëse nevojiten pajisje speciale për nevoja sanitare, ose nevoja sigurie duhen vendosur në avion në këtë fazë.

3.2.12 Transporti i shteteve pjesëmarrëse

Në vendin e pritjes, ose në avion shteti organizator duhet që të asistojë shtetin/et pjesëmarrëse me të kthyerit, apo me eskortat e tyre.

3.2.13 Ngarkimi i bagazheve

Bagazhet e të kthyerve nuk mund të trajtohen si bagazhe dore të cilat mund të mbahen nga vetë të kthyerit. Këto bagazhe do të mbahen në zonën e avionit për bagazhet.

3.2.14 Informim i shkurtër i shefave të eskortave, vëzhguesve, stafit mjekësor, përkthyesve

Në mënyrë që të jepen informacionet më të fundit, p.sh. informacione mbi imbarkimin dhe mbi procedurat gjatë fluturimit, p.sh. mbi lëvizjet në avion, mbi rripin e sigurimit. etj.

Shefat e eskortave të shteteve pjesëmarrëse duhet që të informojnë eskortat e tyre mbi këto informacione të diskutuara.

3.2.15 Informimi i ekuipazhit

Shefi i operacionit/shefi i eskortave i shtetit organizator duhet që të prezantojë veten e tij/saj tek ekuipazhi i avionit si pika kryesore e kontaktit.

Ekuipazhi gjithashtu duhet informuar mbi rreth planit të uljes nëpër vende, mbi numrin e pasagjerëve, mbi peshën e bagazheve, mbi orarin e ushqimit (të kateringut) etj.

3.2.16 Procesi i hipjes në avion

Procesi i imbarkimit do të monitorohet gjithmonë nga shefi i eskortave të shtetit organizator.

Shteti organizator dhe shteti pjesëmarrës kontrollojnë imbarkimet e tyre.

Hipja në avion duhet të rregullohet në mënyrë që të sigurohet së pari ulja në pjesën e vendeve që janë më larg nga pika e hyrjes.

3.3 Faza e fluturimit

3.3.1 Përmbushja e marrëveshjeve

Të gjitha marrëveshjet e mësipërme, si dhe përgatitjet duhen ndjekur nga të gjithë pjesëmarrësit gjatë kësaj faze operacionale.

3.3.2 Shefi i operacionit/shefi i eskortave

Personi i caktuar përgjegjës për të gjithë operacionin monitoron situatën në bord.

Shefat e eskortave të shteteve pjesëmarrëse monitorojnë situatën te grupet e tyre të të kthyerve.

3.3.3 Përdorimi i masave shtrënguese

Kur nevojiten masa shtrënguese, do të jetë shefi i eskortave i cili do të marrë një vendim duke u bazuar në këshillën e eskortave.

Shefat e eskortave të shteteve pjesëmarrëse duhet që të informojnë shefin e eskortave i cili ka përgjegjësinë e marrjes së vendimit final.

3.3.4 Sendet personale të të kthyerve

Paratë dhe/ose sendet me vlerë u duhen dhënë të kthyerve pak para zbritjes. Ndërsa sendet e tjera që i përkasin të kthyerve u duhen kthyer atyre gjatë apo mbas zbritjes.

3.4 Faza e mbërritjes

3.4.1 Kontakti i parë me autoritetet lokale

Shefi i operacionit/shefi i eskortave (i asistuar nga përkthyesi nëse nevojitet) është përgjegjës për realizimin e kontaktit të parë me autoritetet lokale në vendin e destinacionit. Aty ku është rënë dakord për një palë të avancuar (që ka mbërritur më parë) ose nëse në atë vend ndodhet një oficer ndërlidhës pranë ambasadës apo një përfaqësues konsullor, atëherë edhe ata duhet të jenë të pranishëm, gjithashtu.

Shefi i operacionit/shefi i eskortave duhet që të ndjekë udhëzimet e autoriteteve lokale, ose duhet që të arrijë një marrëveshje me këto autoritete në lidhje me procedurat e zbritjes.

3.4.2 Dorëzimi i të kthyerve

Të kthyerit duhet që të dorëzohen pa pranga dhe zakonisht përmes daljes frontale të avionit.

Çdo vend duhet që të dorëzojë të kthyerit e vet. Zakonisht shteti organizator do të dorëzojë i pari të kthyerit e vet, pas tyre do të vijojnë të kthyerit e shtetit pjesëmarrës.

3.4.3 Qëndrimi gjatë natës

Drejtuesi i operacionit ose dikush tjetër në emër të tij/saj duhet që të rregullojë që të realizohet kontakti me shoqëritë e transportit, me hotelet etj., duke bërë të ditur mbërritjen e tyre.

Secili zyrtar dhe secila eskortë është përgjegjëse në lidhje me përputhshmërinë e tij/saj me rregullat e migracionit/të të huajve mbi qëndrimin e tyre në një vend të tretë.

3.5 Faza e fluturimit të kthimit pas përfundimit të operacionit

3.5.1 Konsumimi i pijeve alkoolike

Pijet alkoolike nuk do të lejohen (ose do të lejohen) bazuar në politikën e përcaktuar me kompaninë e fluturimit gjatë mbledhjes që është kryer me të.

3.5.2 Analiza

Rekomandohet që në bordin e avionit, gjatë kthimit, të kryhet një mbledhje për të asistuar shtetin organizator mbi përgatitjen e raportit final. Kjo mbledhje duhet të përfshijë drejtuesin e operacionit, shefat e eskortave, anëtarët e ekuipazhit, personelin mjekësor, si dhe vëzhguesit.

3.6 Raporti final i operacionit të kthimit.

Drejtuesi i operacionit/ shefi i eskortave do të jetë përgjegjës për përgatitjen e një raporti të detajuar mbi operacionin. Ai/ajo do të përshkruajnë operacionin e përbashkët të kthimit, duke nënvizuar ndonjë ngjarje të veçantë, si dhe masat e marra për të zgjidhur problemet që mund të kenë dalë.

4. **Shtojca "*Trajnimi standard për oficerët e operacioneve të kthimeve të përbashkëta*"** është aneks bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi**.**

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen autoritetet përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

SHTOJCË
TRAJNIMI STANDARD PËR OFICERËT E OPERACIONEVE TË KTHIMEVE TË PËRBASHKËTA

KATEGORIA I	
Qëllimi	Shefi i eskortave të ketë një informacion të të gjitha procedurave ligjore dhe aspektet praktike në lidhje me fluturimet e përbashkëta, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin përpara fillimit të operacionit.
KAPITULLI I	**ORGANIZIMI I NJË FLUTURIMI CHARTER**
Qëllimi	Shefi i eskortave duhet të njohë parimet e përgjithshme dhe procedurat se si organizohet një fluturim "*charter*".
Tema 1.1	**Informacion i përgjithshëm**
Njohuritë	**- Destinacioni (p.sh. kërkesa për vizë; informacion mjekësor)** Merr informacionin e duhur në lidhje me kërkesat për vizë, në lidhje me informacionin mjekësor, informacionin kulturor dhe politik, si dhe mbi situatën e sigurisë në vendin e destinacionit. **- Mbërritja dhe orari i veprimeve** Orari i shërbimeve për eskortat dhe për ekuipazhin, përgatitja e një skuadre të dytë eskortash dhe ekuipazh.

	- **Përgjegjësitë dhe detyrat e secilit shtet anëtar pjesëmarrës** Sipas vendimit të këshillit nr. 573/2004, mbi marrëveshjen në lidhje me ushqimin, pijet, uniformat e eskortave, si dhe mbi armët e brezit. - **Përgjegjësitë dhe detyrat e shtetit anëtar organizator** Sipas vendimit të këshillit nr. 573/2004. - **Dominon në organizim legjislacioni vendas i shtetit anëtar organizator** - **Përgjegjësitë e shefit të eskortave të Shtetit organizator (vendim marrës)** - **përgjegjësitë e shefit të eskortave të shtetit Anëtar** - **Pikat e kontaktit për krizat 24/7** Secili shtet pjesëmarrës cakton pikat e kontaktit për rastet e emergjencave të shtetit të tij. Siguron gjithashtu këto pika kontakti për vendin e destinacionit, për vendet fqinje dhe për vendet transit (autoritetet, lista e telefonave e të afërmve të eskortave etj.). - **Roli i FRONTEX gjatë operacioneve të tilla të fluturimit** Njohja e detyrave të FRONTEX në lidhje me këtë operacion specifik të përcaktuara këto nga shteti anëtar organizator. - **Komunikimi/bashkëpunimi me autoritetet e vendit të destinacionit (p.sh. me ambasadat, oficerët e ndërlidhjes, palën e avancuar), si dhe marrëveshjet e firmosura me ta** - **Informimi i shoqërisë ajrore mbi zgjedhjen e kapitenit dhe të ekuipazhit** Mbledhje paraprake me përfaqësuesit e shoqërisë ajrore për të rritur ndërgjegjësimin ndaj natyrës së fluturimit, si dhe ndërgjegjësimin mbi kufizimet e orëve të punës së ekuipazhit. - **Marrëveshje mbi përgjegjësitë dhe mbi kufizimet e ekuipazhit të kabinës** Kapiteni është përgjegjës për avionin, ndërsa eskortat kujdesen për të kthyerit (sipas Konventës së Tokios kapiteni mund të marrë përgjegjësinë për pasagjerët). - **Ndërgjegjësimi i ekuipazhit të kabinës mbi riskun që paraqet natyra/lloji e/i veçantë e/i fluturimit** p.sh. preferohet që të jetë një ekuipazh kabine i gjinisë mashkullore. - **Detyrat e përbashkëta** Sipas vendimit të këshillit 573/2004. - **Gjuha e punës** Bihet dakord ndërmjet shteteve pjesëmarrëse në operacion. - **Regjistrimi i operacionit** Video-regjistrim me marrëveshje ndërmjet shteteve pjesëmarrëse. - **Mbulimi nga Mediat** Me marrëveshje ndërmjet shteteve anëtare. P.sh. deklaratë e përbashkët për shtyp. - **Raportimi i detyrave** Shiko kategorinë, "mbas fluturimit" kapitulli 1, çështja 1.1. - **Paratë e xhepit** Bazuar në kompetencat kombëtare, shtetet anëtare duhet që të informohen në lidhje me politikat e vendeve nëse e lejojnë ose jo. Sendet personale futen në një zarf, ku futen gjithashtu paratë e xhepit të cilat dorëzohen brenda avionit, në fund të fluturimit, nga shefi i eskortave të shtetit përkatës.
Aftësitë	Shefat e eskortave duhet të kenë njohuri të gjera mbi organizimin e fluturimeve "*charter*" si dhe duhen të jenë të aftë që të informojnë anëtarët e skuadrave të tyre sipas çështjeve përkatëse.
Metoda e trajnimit	Në klasa, me grupe pune, konferenca, prezantime me *power point*, si dhe kontribute teorike.
Metoda e vlerësimit	Prezantimi i punës së Projektit i paraqitur nga përgjegjësi i grupit të punës (p.sh. projekti mund të jetë një plan i përgjithshëm operacional).

KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI I	**ORGANIZIMI I NJË FLUTURIMI "CHARTER"**
Çështja 1.2	**Informacioni mbi sigurinë**
Njohuritë	- **Lloji i avionit, konfigurimi i vendeve dhe veçoritë për emergjencat** Përshkrimi i avionit, plani i vendeve, një vizitë në të, harta e aeroportit, përshkrimi i procedurave në aeroporte (pikat kryesore të nisjes, pikat ku do të mblidhen të kthyerit). - **Kontrollet për sigurinë e avionit sipas manualit në vendin e nisjes dhe në**

	vendin e destinacionit. Manualë teknikë në dispozicion për secilin tip avioni. - **Mirëmbajtja e sigurisë së avionit mbas kontrollit të sigurisë** Zonë e pastër (termi quhet "APOLLO"), Marrëveshje mbi kush është përgjegjës për sigurinë e avionit në fushë. - **Vlerësimi i riskut të të kthyerve (background-i i tyre kriminal dhe i sjelljes, aspektet mjekësore/shëndetësore të tyre, si dhe aspektet kulturore)** - **Informacioni mbi sigurinë në vendin e destinacionit, në vendin transit.** Autoritetet përgjegjëse, eksperiencat e mëparshme, aeroportet, si dhe procedurat e mundshme të sigurisë. - **Marrëveshjet e dorëzimit në vendin e destinacionit** Të kthyerit do të dorëzohen tek autoritetet në vendet specifike/të caktuara me prezencë të përfaqësuesve diplomatikë, me përfshirjen e OJQ-ve etj. (p.sh. observues të të drejtave të njeriut në shtetin anëtar organizator, si dhe të vendit të destinacionit). - **Roli i kapitenit** Sipas/bazuar në Konventës së Tokios (Marrëveshja BUT mbi kush e merr përgjegjësinë). - **Bashkëpunimi me pjesëtarët e ekuipazhit (ekuipazhin e fluturimit dhe të kabinës)** Bazuar në informacionin e ndarë me shoqërinë ajrore dhe nëse është e mundur edhe me kapitenin dhe me ekuipazhin. - **Marrëveshje në lidhje me raportin/numrin e eskortave dhe të të kthyerve** Me marrëveshje ndërmjet shteteve pjesëmarrëse (duke përfshirë edhe skuadrën mbështetëse e cila i jep ndihmë eskortave nëse është e nevojshme – shih vendimin e këshillit nr. 573/2004).
Aftësitë	Shefat e eskortave duhet të kenë një pamje të qartë të informacionit mbi sigurinë në mënyrë që të sigurojnë një fluturim kthimi të përbashkët të sigurt.
Metoda e trajnimit	Në klasa, me grupe pune, konferenca, prezantime me *power point*, si dhe kontribute teorike.
Metoda e vlerësimit	Prezantim i zgjidhjes për një rast konkret
KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE- PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI I	**ORGANIZIMI I NJË FLUTURIMI "CHARTER"**
Çështja 1.3	Procedurat që aplikohen gjatë operacionit të kthimit
Njohuritë	- **Masat shtrënguese** Dominon ligji kombëtar (i shtetit organizator). - **Marrëveshje të veçanta** Marrëveshje mbi operacione kthimi specifike. - **Leje transiti dhe procedurat në rastet e një territori të huaj.** - **Përgjegjësitë gjatë operacionit** Dominon ligji kombëtar (i shtetit organizator). - **Personeli mjekësor dhe përkthyesit** Me marrëveshje, zakonisht një Shtet sjell personel mjekësor). - **Vëzhguesit (organizata qeveritare dhe joqeveritare)** - **Lista e personelit që lejohet** Personeli që lejohet të hipi "*on board*" (me përjashtim të shtypit) – siguria "*on board*". - **Përgjegjësitë dhe kufizimet e personelit të kabinës**
Aftësitë	Shefi i eskortave duhet që të dijë që më parë të gjitha procedurat që aplikohen në mënyrë që të sigurohet një veprim i njëjtë.
Metoda e trajnimit	Punë me grupe; klasa; konferenca.
Metoda e vlerësimit	Prezantim i përbashkët.

KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE- PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI 2	**MASAT E KONTIGJENCËS**
Qëllimi	Shefi i eskortave duhet të jetë në gjendje të përballojë çdo situatë të papritur apo emergjenca duke njohur procedurat që do të ndjekë.

Çështja 2.1	Procedurat për të kthyerit INAD (i papranueshëm)
Njohuritë	- **Marrëveshja e ripranimit** I referohet marrëveshjeve kombëtare, marrëveshjeve me BE-në. **Marrëveshje të veçanta (nga ndonjë palë që ka shkuar më parë, nga Ambasada, nga oficerët e ndërlidhjes etj.)** Të njihen marrëveshjet specifike, nëse ka të tilla. - **Kontaktet me Ambasadën** - **Pikat e Ndërlidhjes për krizat 24/7 (gjatë gjithë kohës)** Nëse nuk ka mundësi të tjera – të kthyerit do të kthehen mbrapsht në shtetet respektive.
Aftësitë	Shefi i eskortave do të jetë në gjendje të aplikojë procedurat e duhura.
Metoda e trajnimit	Në klasë.
Metoda e vlerësimit	
KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE- PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI 2	**MASAT E KONTIGJENCËS**
Çështja 2.2	**Emergjencat gjatë operacionit të kthimit**
Njohuritë	- Kushtet mjekësore; teknike; klimaterike të emergjencave të cilat të çojnë në: • Shmangie ose ulje gjatë rrugës për në vendin e destinacionit • Shmagie ose ulje gjatë rrugës së kthimit. Njohje e procedurave (plani i emergjencave-"Plani B"), e përgjegjësive për sigurinë e pasagjerëve dhe të avionit, si dhe të informimit të pikave të kontaktit. - Pikat e kontaktit për krizat 24 orë/7 ditë (gjatë gjithë kohës). • Lidhjet me shtetet dhe me qendrat e emergjencave.
Aftësitë	Shefi i eskortave duhet të njohë procedurat standarde operacionale.
Metoda e trajnimit	Lojë me role.
Metoda e vlerësimit	Test praktik.

KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE- PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI 3	**KORNIZA LIGJORE**
Qëllimi	Shefi i eskortave duhet të njohë aspektet respektive të legjislacionit të cilat lidhen me operacionet e përbashkëta të kthimeve.
Çështja 3.1	Marrëveshjet ndërkombëtare.
Njohuritë	• Konventa e Çikagos (si hyrje). • Konventa e Tokios (kompetencat e komandantit të avionit). • Konventa e Gjenevës (në rastet e azil-kërkuesve). • Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut. Një pamje e përgjithshme e shkurtër e pjesëve që kanë lidhje me konventat e sipërpërmendura.
Aftësitë	Shefi i eskortave duhet të ketë një njohuri të përgjithshme të marrëveshjeve të përmendura më sipër në mënyrë që të kuptohet përshtatshmëria me konventat.
Metoda e trajnimit	Në klasë.
Metoda e vlerësimit	

KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI 3	**KORNIZA LIGJORE**
Çështja 3.2	**Legjislacioni i BE**
Njohuritë	Vendim i Këshillit 2004/573/EC dhe Direktiva e Këshillit në mënyrë që të kuptojë përshtatshmërinë e kuadrit ligjor.
Aftësitë	- Shefi i eskortave duhet të ketë një njohje të përgjithshme mbi legjislacionin e përmendur më sipër në mënyrë që të kuptojnë përshtatshmërinë e kornizës ligjore.

	Një njohje e përgjithshme e pjesëve të legjislacionit të përmendur që lidhen me çështjen.
Metoda e trajnimit	Në klasë.
Metoda e vlerësimit	

KATEGORIA I	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE- PARAPËRGATITJET**
KAPITULLI 3	**KORNIZA LIGJORE**
Çështja 3.3	**Legjislacioni kombëtar i vendit që udhëheq operacionin**
Njohuritë	- Informacion i përgjithshëm rreth aplikimit të ligjit për operacione specifike. I përgatitur edhe për Shtetet e tjera Pjesëmarrëse nga Shteti Anëtar i cili drejton operacionin.
Aftësitë	Shefi/shefat e eskortave do të jenë në gjendje të veprojë në sipas legjislacionit kombëtar të Shtetit që e udhëheq Operacionin.
Metoda e trajnimit	Në klasë.
Metoda e vlerësimit	

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
Qëllimi	Mundësimi i personelit të eskortave që të marrin pjesë në një fluturim të përbashkët.
KAPITULLI 1	**FAZA 1: FILLIMI I OPERACIONIT**
Qëllimi	Shefi/shefat e eskortave duhet të kuptojnë dhe të zbatojnë veprimet e nevojshme për të filluar operacionin.
Çështja 1.1	**Kontakti i parë me të kthyerit nga shteti anëtar pjesëmarrës**
Njohuritë	• **Kontrolli i dokumenteve** Dokumentet mjekësore, laissez passer, pasaporta, listat e artikujve personal, leja e kalimit transit (nëse është e nevojshme). • **Informacion procedurial** Të kthyerve u shpjegohet pjesa e deportimit. • **Njohuritë/ndërgjegjësimi për të respektuar kulturën** • **Vlerësimi i riskut** p.sh. sjellja që shfaqin, reagimi ndaj kontrollit fizik (trupor). • **Masa të veçanta mbrojtëse të përdorura nga shtetet pjesëmarrëse anëtare:** p.sh. helmeta, prangosje të trupit, rroba mbrojtëse, shiko kategoria I, kapitulli 1, çështja 1.3.
Aftësitë	**Rojat e kufirit do të jenë në gjendje të:** • Të kryejnë një kontroll fizik (trupor). • Të kryejnë kontroll të bagazheve dhe të artikujve personal. • Të marrin masa të veçanta mbrojtëse, të përdorin pajisje të veçanta • Të kryejnë kontroll dokumentesh.
Metoda e trajnimit	Trajnim praktik, lojë me role (p.sh. duke fshehur objekte të rrezikshme). Mësime teorike.
Metoda e vlerësimit	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 1	**FAZA 1: FILLIMI I OPERACIONIT**
Çështja 1.2	Transporti për në avion.
Njohuritë	• Procedurat për të kaluar të kthyerit përmes zonës së sigurisë së aeroportit për në avion. • Teknikat për të sjellë të kthyerit brenda një makine, apo për t'i nxjerrë ata nga makina në mënyrë të sigurt sipas standardeve të trajnimeve kombëtare.
Aftësitë	Rojat kufitare do të jenë në gjendje të aplikojnë teknikat dhe procedurat në praktikë.
Metoda e trajnimit	Trajnim praktik. Mësime teorike.
Metoda e vlerësimit	Korrektim individual gjatë trajnimit.
KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 2	**FAZA 2: GJATË OPERACIONIT**
Qëllimi	Shefat e eskortave dhe rojat kufitare duhet të reagojnë menjëherë ndaj çdo situate gjatë fluturimit dhe të qëndrojnë të përqendruar te detyrat e tyre.

Çështja 2.1	**Kontakti me kapitenin dhe me ekuipazhin përpara se të hipet në avion**
Njohuritë	• Shefi i eskortave prezanton veten. • Shpjegime mbi operacionin. Kapiteni i dorëzon shefit të eskortave përgjegjësinë për pasagjerët (personelin e eskortave dhe të kthyerit). • Raporti mbi situatën.
Aftësitë	Shefi i eskortave është në gjendje që t'i japë stafit të avionit një informim të shkurtër në lidhje me rolin/përgjegjësitë e ekuipazhit.
Metoda e trajnimit	Mësime teorike dhe trajnime praktike, loja me role.
Metoda e vlerës	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PERBASHKET I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 2	**FAZA 2: GJATE OPERACIONIT**
Çështja 2.2	**Hipja në avion**
Njohuritë	Procedurat e hipjes në avion të Shtetit Organizator.
Aftësitë	Shefi i eskortave është në gjendje që të zbatojë procedurat kombëtare të Shtetit Organizator për hipjen në avion.
Metoda e trajnimit	Mësime teorike dhe trajnime praktike sipas udhëzimeve kombëtare
Metoda e vlerës	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 2	**FAZA 2: GJATË OPERACIONIT**
Çështja 2.3	**Organizimi i sigurisë së udhëtimit**
Njohuritë	• **Procedurat e sigurisë për furnizimin me ushqime** (të mos ketë: thika, pije, ushqim të ftohtë, pjata plastike). • **Procedurat e sigurisë për lëvizjet në board** (vajtja në tualet, ndarja e tualeteve për eskortat dhe për të kthyerit: varet nga avioni, të mos ketë lëvizje të pakontrolluara). • **Reagimi në rastet e incidenteve (p.sh. të dëmtimit të vetes)** Seksion i veçantë për kujdesin mjekësor, seksion i veçantë për SHP, seksion i veçantë për familjet, minorenët, minoritetet. • **Plani i të ulurit (i vendeve) përfshirë edhe planin në kohë emergjence** Seksione të ndara për kujdesin mjekësor të veçantë; Seksione të ndara për secilin Shtet Anëtar Pjesëmarrës; Seksione të ndara për familjet, minorenët, minoritetet. • **Ndihma e shpejtë (nëse nuk do të ketë personel mjekësor)**
Aftësitë	Rojat e kufirit janë në gjendje të përdorin teknikat ndërhyrëse (p.sh. përdorimi i forcës fizike dhe i pajisjeve në avion), si dhe për dhënien e ndihmës së shpejtë.
Metoda e trajnimit	Mësime teorike dhe trajnime praktike, loja me role (p.sh. mbi fshehjen e objekteve/artikujve të rrezikshëm).
Metoda e vlerësimit	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 3	**FUNDI I OPERACIONIT**
Qëllimi	Shefi i eskortave duhet të jetë në gjendje/i aftë të dorëzojë të kthyerit tek autoritetet lokale.
Çështja 3.1	Kontakti me Autoritetet e huaja (drejtuesit e Fluturimit të Përbashkët me Autoritetet Lokale të Migracionit ose të Policisë).
Njohuritë	Kompetenca mbi njohuritë kulturore (duke përdorur planin kombëtar ose modelin e bashkëngjitur). p.sh. njohuri mbi kulturën Islame dhe mbi zakonet.
Aftësitë	Shefi i eskortave është në gjendje të veprojë sipas zakoneve lokale dhe kompetencave (njohurive)/ndërgjegjësimit kulturor.
Metoda e trajnimit	Teori, si dhe punë në grupe.
Metoda e vlerësimit	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA II	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE - OPERACIONI**
KAPITULLI 3	**FUNDI I OPERACIONIT**

Çështja 3.2	**Disimbarkimi (Zbritja)**
Njohuritë	Informacion i Përgjithshëm në lidhje me procedurat që aplikohen nga vendet pritëse. 1. Zbritje individuale. 2. Zbritje në grup. 3. Drejtim i pyetjeve që më parë. 4. Drejtimi i pyetje në zyrë. 5. Shefi i eskortave dhe përkthyesi zbresin të parët.
Aftësitë	Rojat e kufirit të jenë në gjendje të kryejnë në mënyrë korrekte të gjitha fazat e procedurave të zbritjes në vendin pritës.
Metoda e Trajnimit	Të mësuarit duke praktikuar, loja me role.
Metoda e Vlerësimit	Korrektim individual gjatë trajnimit.

KATEGORIA III	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE – MBAS FLUTURIMIT**
KAPITULLI 1	**VLERËSIMI**
Qëllimi	Shefi i eskortave duhet të jetë në gjendje të raportojë, të analizojë pro-të dhe kundra-t e operacionit të përbashkët të kthimit, si dhe të japë rekomandime.
Çështja 1.1	**Raporti**
Njohuritë	- Një listë me të gjitha çështjet e parashqyrtuara/ e parashikuara në lidhje me të kthyerit për tu mbushur gjatë fluturimit (ka gjithashtu edhe një specimen si bazë për këtë listë) ku të përfshihen: • Trajtimi i veçantë për secilin të kthyer (p.sh. ruajtja nga tentativat e vetëvrasjes; trajtimi mjekësor). • Aneks (shtojcë) për të përshkruar të kthyerit e dëmtuar. • Aneks (shtojcë) për masat shtrënguese të përdorura (p.sh. përdorimi i prangave, kohëzgjatja e kësaj mase). • Orari i zgjatjes së të gjithë operacionit. • Raport shtesë mbi incidentet e ndodhura.
Aftësitë	Shefi i eskortave do të jetë në gjendje/i aftë që të shkruajë një raport të plotë mbi bazën e listës së sipër-përmendur duke përfshirë edhe rekomandime.
Metoda e Trajnimit	Praktik (mbushja/plotësimi i listës si dhe përgatitja e raportit).
Metoda e Vlerësimit	

KATEGORIA III	**FLUTURIMI I PËRBASHKËT I KTHIMEVE – MBAS FLUTURIMIT**
KAPITULLI 1	**VLERËSIMI**
Çështja 1.2	*Feedback-u* (reflektimi/reagimi)
Njohuritë	- Analiza e raportit. - Vlerësim dhe rekomandime të përgjithshme.
Aftësitë	Shefi i eskortave do të jetë në gjendje të fokusohet në aspektet që kanë lidhje me raportimin për fluturimin e përbashkët.
Metoda e Trajnimit	Në klasë, grupe pune.
Metoda e Vlerësimit	